



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës -Tužilački Savet Kosova – Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të Nenit 7(1.31) të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në përputhje me Nenin 17 (7) të Ligjit Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale, në mbledhjen e mbajtur më _____ miraton:

RREGULLORE PËR
THEMELIMIN DHE FUNKSIONIMIN E EKIPEVE TË PËRBASHKËTA TË
HETIMIT

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve të punës, organizimit të brendshëm, metodave operacionale, bashkëpunimit dhe procedurave të punës së Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit (në tekstin e mëtejshëm: EPH), që veprojnë në kuadër të mandatit të Prokurorisë Speciale, siç përcaktohet me ligj.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga Prokuroria Speciale, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe institucionet publike, që janë të detyruara të bashkëpunojnë me Prokurorinë Speciale.

Neni 3
Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1.1 **Ekipi i Përbashkët i Hetimit** - Një ekip hetimor ndërinstitutional, i themeluar nën autoritetin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale, në pajtim me ligjin përkatës për Prokurorinë Speciale. Ekipi ndërinstitutional vepron në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe mund të kalojë në një Ekip të Përbashkët Hetimor Ndërkombëtar nëse hetimi zhvillohet në aspektin ndërkombëtar, sipas legjislacionit në fuqi.

1.2 Hetuesi kryesor - nënkupton njërin nga anëtarët e Ekipit të Përbashkët të Hetimit, përveç prokurorit special, i cili autorizohet nga prokurori si bartës kryesor i rastit, me qëllim të koordinimit të veprimeve me anëtarët e tjerë të ekipit, në kuadër të strategjisë së hetimit, varësisht nga natyra e rastit.

Neni 4

Themelimi i Ekipit të Përbashkët të Hetimit dhe periudha e funksionimit

1. Propozimi për të themeluar EPH për rastin e caktuar bëhet nga prokurori udhëheqës i rastit pas vlerësimit të kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore dhe rrethanave të rastit.
2. Propozimi nga paragrafi 1 bëhet me shkrim dhe përfshin këto elemente:
 - 2.1 Arsyetimin për themelimin e EPH-së, duk u bazuar në kriteret e përcaktuara me ligj dhe me këtë rregullore;
 - 2.2 Institucionet dhe agjencitë e nevojshme, të cilat do të jenë pjesë e ekipit dhe arsyetimin për përfshirjen e tyre dhe
 - 2.3 Periudhën e funksionimit të EPH-së në pajtim me afatin e hetimit, të përcaktuar sipas KPPRK-së.
3. Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale vendos për themelimin e EPH-së brenda tridhjetë (30) ditëve prej momentit të pranimi të propozimit.
4. EPH themelohet për periudhën kohore, e cila është përcaktuar në propozimin e prokurorit të rastit.
5. Periudha e funksionimit të EPH-së mund të vazhdohet nga Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, sipas propozimit të prokurorit të rastit, në pajtueshmëri me afatin e hetimit të përcaktuar me KPPRK-në.
6. Prokurori udhëheqës do të përcaktojë institucionin kryesor në hetim nga radhët e institucioneve pjesëmarrëse në hetim dhe zyrtarin që do të jetë hetuesi kryesor. Prokurori udhëheqës mund të ndryshojë institucionin kryesor në hetim, ndërsa hetimi përparon dhe rrethanat e situatat ndryshojnë.

Neni 5

Përbërja dhe kriteret për themelimit e Ekipit të Përbashkët të Hetimit

1. EPH përbëhet nga prokurori i rastit në Prokurorinë Speciale dhe zyrtarë të deleguar nga institucionet dhe agjencitë e tjera zbatuese të ligjit. Prokurori i rastit njëherësh është edhe udhëheqës i EPH-së.

2. EPH mund të përfshijë edhe prokurorë të tjerë nga Prokuroria Speciale apo prokuroritë themelore, të cilët ndërmarrin veprime hetimore dhe punojnë nën drejtimin e prokurorit udhëheqës të rastit.

3. EPH themelohet për hetimin dhe ndjekjen e rasteve në kompetencë të Prokurorisë Speciale, të cilat i përmbushin kriteret e përcaktuara si në vijim:

3.1 Hetimi ka të bëjë me veprat penale të parapara në nenin 9 dhe 10 të Ligjit për Prokurorinë Speciale.

3.2 Natyra e hetimit duhet të jetë përtej nevojave dhe praktikës normale hetimore.

3.3 Bashkëpunimi i institucioneve dhe agjencive të ndryshme zbatuese të ligjit është i nevojshëm për një hetim efektiv.

Neni 6

Kriteret dhe procedurat e caktimit të anëtarëve të Ekipit të Përbashkët të Hetimit

1. Zyrtarët që plotësojnë kriteret si në vijim mund të caktohen në EPH:

1.1 Të kenë statusin e zyrtarit të punësuar në institucionet përkatëse;

1.2 Të kenë përvojë hetimore dhe analitike në trajtimin e rasteve si pjesë e punës së tyre dhe rezultate të dëshmuara në punën e tyre;

1.3 Të kenë ekspertizë të veçantë për natyrën e hetimit që do të zhvillohet;

1.4 Të jenë në gjendje të punojnë në ambient ekipor, të zhvillojnë dhe ndjekin linjat përkatëse të hetimit, të kenë aftësi efektive komunikimi dhe

1.5 Të kenë dosje të pastër disiplinore, pa shkelje të rëndë të detyrave të tyre.

2. Anëtarët e EPH-së nga radhët e Policisë së Kosovës do të delegohen nga Drejtori i Departamentit të Hetimit në Policinë e Kosovës, ndërsa nga institucionet apo agjencitë e tjera, nga zyrtarët më të lartë në hierarki, pas kërkesës së prokurorit që udhëheq rastin.

3. Anëtarët e përzgjedhur të ekipit sipas nevojës mund të vendosen fizikisht në objektin e Prokurorisë Speciale për drejtimin dhe menaxhimin më të mirë të hetimit.

4. EPH, sipas nevojës, mbështetet nga zyrtarët e tjerë që punojnë në kuadër të institucioneve përkatëse varësisht nga natyra e rastit.

Neni 7

Menaxhimi dhe përgjegjësitë e Ekipit të Përbashkët të Hetimit

1. Në përputhje me ligjin, prokurori i rastit udhëheq hetimin në EPH. Prokurori mund të caktojë një hetues kryesor në kuadër të EPH-së, i cili duhet të drejtojë ekipin hetimor në baza ditore dhe sigurojë që urdhrat dhe plani hetimor po zbatohen.
2. Plan i hetimor vendoset dhe zbatohet nga prokurori i rastit në koordinim me anëtarët e tjerë të EPH-së.
3. Hetuesi kryesor do të jetë përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të ekipit hetimor, do të sigurojë drejtimin dhe kohezionin e ekipit, si dhe do të sigurojë që pistat e hetimit janë në përputhje me drejtimin strategjik dhe vendimmarrjen e prokurorit.
4. Refuzimi për të ndarë informata brenda EPH-së ose mungesa e vullnetit për të përfunduar veprimet ose ndjekur pistat e hetimit dhe çdo sjellje joprofesionale mund të çojë në largimin e anëtarit nga ekipi dhe për këtë do të njoftohet institucioni apo agjencia përkatëse, e cila e ka deleguar atë, me qëllim të inicimit të procedurës disiplinore ndaj tij.
5. Anëtarët e ekipit janë të detyruar të bashkëpunojnë ngushtë me prokurorin udhëheqës të ekipit dhe me hetuesin kryesor, duke siguruar përpjekje kohezive dhe të unifikuar hetimore.

Neni 8

Integriteti operacional, fshehtësia dhe konfidencialiteti i hetimit

1. Anëtarët e ekipit në asnjë rrethanë nuk mund të diskutojnë ose zbulojnë asnjë informatë në lidhje me hetimin tek askush tjetër jashtë EPH-së. Për çdo kërkesë për të marrë informacion lidhur me hetimin, anëtarët e EPH-së duhet ta njoftojnë prokurorin e rastit.
2. Anëtarët e ekipit nuk mund të ndajnë informacione lidhur me hetimet me menaxherët e linjës në institucionin e tyre, pa aprovimin paraprak të prokurorit udhëheqës.
3. Anëtarët e ekipit që refuzojnë të japin informata në lidhje me hetimin tek menaxherët e linjës në institucionin e tyre nuk do të jenë subjekt i ndonjë procedure disiplinore brenda institucionit ose agjencisë përkatëse. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në transferimin, pezullimin, hetimin, disiplinimin ose çfarëdo forme të trajtimit të padrejtë. E njëjta vlen edhe pas përfundimit të hetimit.
4. Anëtari i ekipit që zbulon ndonjë informatë lidhur me rastin që është në hetim do t'i nënshtrohet procedurave penale dhe disiplinore sipas legjislacionit përkatës.

Neni 9

Angazhimi i zyrtarëve të institucioneve publike ose agjencive në Ekipin e Përbashkët të Hetimit

1. Institucionet publike ose agjencitë e zbatimit të ligjit delegojnë zyrtarët e tyre për të qenë anëtarë të EPH-së sipas kërkesës së Prokurorisë Speciale.
2. Zyrtarët e deleguar nga institucionet publike ose agjencitë për zbatimin e ligjit, sa i përket aspektit administrativ mbesin zyrtarë me të drejta dhe detyrime të plota ndaj institucionit delegues, kurse sa i përket aspektit operativ i përgjigjen dhe i raportojnë prokurorit udhëheqës të rastit.
3. Prokurori që udhëheq hetimin do të përgatisë raport në lidhje me performancën e zyrtarit gjatë kohës së angazhimit në EPH. Raporti i performancës bëhet pjesë e dosjes së zyrtarit dhe merret parasysh gjatë vlerësimit të rregullt të performancës në institucionin ose agjencinë deleguese.
4. Prokurori udhëheqës, në konsultim me institucionin ose agjencinë përkatëse, mund të refuzojë ose të kthejë një anëtar të ekipit të deleguar në institucionin apo agjencinë përkatëse për shkak të mosplotësimit të kriterëve që kërkojnë për të qenë pjesë e EPH-së, evidentimit të performancës së dobët ose në rast se kontributi i anëtarit në ekip nuk është më i nevojshëm.
5. Në rast të shkeljeve disiplinore, prokurori udhëheqës ndërprejë menjëherë aktivitetin e anëtarit të Ekipit të Përbashkët të Hetimit dhe raporton për shkeljen në institucionin apo agjencinë deleguese. Procedura disiplinore kundër anëtarit të EPH-së zhvillohet nga institucioni apo agjencia që e ka deleguar.
6. Ky nen nuk zbatohet për prokurorët që udhëheqin ose janë anëtarë të EPH-së, siç parashihet me këtë rregullore.

Neni 10

Mbikëqyrja e zhvillimit të hetimit të Ekipit të Përbashkët të Hetimit

1. Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale ose në mungesë të tij, Zëvendëskryeprokurori, me mbështetje të udhëheqësit të departamentit përkatës, mbikëqyrë ecurinë e hetimeve të EPH-së në periudha të caktuara kohore sipas vlerësimit të tij, por gjithsesi çdo tre muaj.
2. Prokurori i rastit, njëherësh udhëheqësi i EPH-së i ofron informatat lidhur me rastin dhe dokumentacionin e nevojshëm Kryeprokurorit ose në mungesë të tij Zëvendëskryeprokurorit, në çdo moment kur kërkohet një gjë e tillë.
3. Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale ose në mungesë të tij Zëvendëskryeprokurori mund të japë komente dhe sugjerime me qëllim të ngritjes së efikasitetit të hetimeve, duke siguruar integritet dhe objektivitet gjatë gjithë kohës së hetimeve.

Neni 11

Shuarja e Ekipit të Përbashkët të Hetimit

1. Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale mund të shuajë EPH-në në çdo kohë kur:

1.1 Hetimi ka përfunduar;

1.2 Anëtarët e ekipit kanë përfunduar të gjitha detyrat e tyre dhe hetimi mund të vazhdojë në mënyrë të rregullt;

1.3 Faktet dhe rrethanat e rastit tregojnë që hetimi nuk ka nevojë për një hetim ndërinstitutional;

1.4 Kriteret për krijimin e EPH-së nuk janë më të vlefshme dhe

1.5 Hetimi ka ngecur dhe një qasje tjetër është e nevojshme për të përfunduar hetimin.

2. Pas shuarjes së EPH-së, të gjithë anëtarët vazhdojnë punën në institucionet ose agjencitë përkatëse delegeuse.

Neni 12

Buxheti dhe rregullimet e tjera administrative

1. Zyrtarët e deleguar nga institucionet publike ose agjencitë për zbatimin e ligjit do të realizojnë pagat dhe çfarëdo kompensimi shtesë nga buxheti i institucionit ose agjencisë përkatëse që i ka deleguar në EPH.

2. Institucionet dhe agjencitë që delegojnë anëtarët e EPH-së vendosin në dispozicion të EPH-së resurset, bazat e të dhënave, mjetet, veturat dhe pajisjet e tjera të tyre, të cilat i kanë në dispozicion.

3. Prokuroria Speciale, sipas nevojës, ofron hapësira të zyrës, kompjuterë dhe pajisje të tjera për anëtarët e EPH-së.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, datë:

Ardian Hajdaraj
Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës